



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC
OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data:	13.01.2023
Numër:	07/zyrtar
Për:	Kryesuesen e Kuvendit Komunal, Gjakovë
C.C.	Anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa /Asamblesë Komunale, Gjakovë
Nga:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit Drejt, Arben Bakalli
Lënda:	Kërkesë për nxjerrjen e Vendimit për hapjen e shqyrtimit publik të projekt "Harta Zonale Komunale 2022-2030"

Të nderuar,

Me rastin e marrjes së pëlqimit nga ana e MMPHI –së me nr. SP-02nr.7588-2/22 datë 11.01.2023, sipas procedurave ligjore nevojitet nxjerrja e vendimit për hapjen e shqyrtimit publik të projekt "Harta Zonale Komunale 2022-2030" .

Me respekt!

Bashkangjitur me kërkesën:

- Vendimi i MMPHI-së nr., dt.
- Propozim vendimi për hapjen e shqyrtimit publik

KOMUNA E GJAKOVËS

DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Postal address: Nëna Tereze Gjakovë, Kosovë

Tel: +381 390 322 452, 323 210, 320 070 Fax: +381 390 322 452

www.gjakova-komuna.org

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNO PLANIRANJE I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

Njësia org.
Org. Jednica
Org. Unit
Nr. i Fajëve
Br. Stranica
No. Pages

SP-02.
- 02 -

Nr. i Prot.
Broj Prot.
Prot. No.
Datum
Date

7588-2/22
11.01.23

PRISHTINË / A

No. 1



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostorno Planiranje i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm /Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

DATË/A:	10.01.2023
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Arben Bakalli - Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrotjtjes të Mjedisit-Komuna e Gjakovës
CC:	Ardian Gjini , Kryetar i Komunës së Gjakovës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Servet Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për pëlqim për hapjen e shqyrtimit publik të Projekt “Harta Zonale e Komunës së Gjakovës 2022-2030”

I nderuar z. Bakalli,

Bazuar në Ligjin Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor neni 11 (paragrafi 1.9, nën paragrafi 1.9.2) Komuna e Gjakovës ka dorëzuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me datë 13.12.2022 me numër të protokollit 7588/22, kërkesën “për marrjen e pëlqimit për hapjen e shqyrtimit publik të Projekt “Harta Zonale e Komunës së Gjakovës 2022-2030”.

Sipas nenit (9 paragrafi 2 nën paragrafit 2.3), Ministria Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është përgjegjëse për vlerësimin e përputhshmërisë së Projekt “Harta Zonale e Komunës së Gjakovës 2022-2030” me “Planin Hapësinor të Kosovës –Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+” dhe me Udhëzimin Administrativ MMPH-Nr.08/2017 Për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.

Duke u bazuar në nenin 20 të Ligjit Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor dhe në nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr. 05/2014 për Përgjegjësit e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor, Ministria nxjerr Vendim për pëlqim, që Kuvendi i Komunës së Gjakovës sipas procedurës për Përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor, **Mund të bëjë Hapjen e Shqyrtimit Publik.**

Me respekt,





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA OF KOSOVA / РЕПУБЛИКА КООСОВА	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia reg. Org./Instituti Org./Unit	DPHNB
Nr./Faqe Rr./Stranica No./Pages	04
Nr./Prot. Broj Prot. Prot. No.	7588-2/22
Data Datum Date	10.01.22
PRISHTINË / A	
No. 1	

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA / VLADA / GOVERNMENT

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit / Departament Prostornog Planiranja,
Gradnje i Stanovanje / Department of Spatial Planning, Construction and Housing

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:	
PËR/ZA/TO:	Servet Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Xhemal Metolli, Zëvendësues i Udhëheqësit të Departamentit të Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
NGA/OD/FROM:	Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Draft- Vendim për pëlqim për hapjen e shqyrtimit publik të Projekt - "Harta Zonale e Komunës së Gjakovës 2022-2030"

I nderuari z. Spahiu,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës më datë 13.12.2022 me numër të protokollit 7588/22 ka pranuar shkresë nga Komuna e Gjakovës, me anë të cilës komuna dorëzon "Projekt - Harta Zonale e Komunës së Gjakovës 2022-2030" dhe kërkon nga MMPHI vlerësimin e përputhshmërisë me "Planin Hapësinor të Kosovës –Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+", sipas Ligji Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor neni 11. paragrafi 1. nenparagrafi 1.9. dhe nen-nën paragrafi 1.9.2.

Divizioni i Planifikimit Hapësinor dhe Komisioni Këshillëdhënës dhe Rekomandues ka shqyrtuar Projekt - "Harta Zonale e Komunës së Gjakovës 2022-2030", duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor, gjithashtu pas shqyrtimit nga Departamenti Ligjor shkresa të përcjellët për procedim të mëtutjeshëm.

Me respekt,



REPUBLIKA E KOSOVËS
/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF
GJAKOVA



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika d, nenit 17, pika b dhe nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 5, paragrafi 1.2 nën paragrafi 1.2.2, nenit 10 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1, nenit 11, paragrafi 1, nën paragrafi 1.12 dhe nenit 20 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174, dhe Udhëzimit Administrativ të MMPHI-së Nr. 05/2014 Për Përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor, neni 4, paragrafi 3, pika 3.1, neni 7, paragrafi 3, neni 8, neni 10, neni 12 dhe neni 14, si dhe neni 14 të Statutit të Komunës së Gjakovës Nr. 01/ Nr. 011-332/2010 të datës 21.01.2010, Kuvendi i Komunës së Gjakovës në mbledhjen XX të mbajtur me datën _____ / 2023 nxjerr këtë:

VENDIM

Për vënien në shqyrtim publik të projekt “HARTA ZONALE KOMUNALE E GJAKOVËS 2022-2030”

Neni 1

Me këtë vendim vihet në shqyrtim publik projekt “Harta Zonale Komunale e Gjakovës 2022-2030”

Neni 2

2.1 Hapja zyrtare e shqyrtimit publik dhe prezantimi i projekt “Harta Zonale Komunale e Gjakovës 2022-2030” bëhet në sallën e Asamblesë së Kuvendit Komunal 8 (tetë) ditë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2.2 Ekspozimi i projekt “Harta Zonale Komunale e Gjakovës 2022-2030” bëhet në sallën e Asamblesë së Kuvendit Komunal.

2.3 Shqyrtimi publik i projekt “Harta Zonale Komunale e Gjakovës 2022-2030” zgjatë 30 (tridhjetë) ditë sipas procedurave të përcaktuara me ligj.

2.4 Shpallja e shqyrtimit publik të projekt “Harta Zonale Komunale e Gjakovës 2022-2030 ” bëhet 8 (tetë) ditë para hapjes së tij përmes mjeteve të informimit publik, faqen zyrtare të komunës dhe në mediat televizive publike dhe lokale.

Neni 3

3.1 Në shqyrtimin publik prezantohet pjesa tekstuale dhe grafike e projekt “Harta Zonale Komunale e Gjakovës 2022-2030”

3.2 Projekt “Harta Zonale Komunale e Gjakovës 2022-2030” është i qasshëm për publikun në formë të shtypur dhe elektronike.

Neni 4

4.1 Projekt “Harta Zonale Komunale e Gjakovës 2022-2030” i nënshtrohet vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve të publikut para se të finalizohet.

4.2 Të gjitha vërejtjet, komentet dhe sugjerimet që paraqiten nga publiku me gojë gjatë diskutimeve, me shkrim në librin e vërejtjeve apo përmes adresës elektronike, brenda afatit kohor të përcaktuar, përfshihen në raportin mbi shqyrtimin publik.

Neni 5

Pas përfundimit të shqyrtimit publik të projekt “Harta Zonale Komunale e Gjakovës 2022-2030”, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Mjedisit si autoritet përgjegjës për planifikim hapësinor, do të kryej veprimet e parapara ligjore për finalizimin e këtij dokumenti në mënyrë që ai t’i prezantohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.

Kryesuesi i Kuvendit

Zonj. Arbëresha Kuqi